



Kosova dhuron 2023

RAPORT MBI GJENDJEN E FILANTROPISË



793

numri i rasteve



8,740,940.3 EUR

shuma e regjistruar




5 EUR

të dhuruara për kokë banori


Viti 2023 shënoi vëllimin më të madh të mbështetjes filantropike në Kosovë, një vëllim më i lartë se shuma e dhuruar gjatë rrethanave sfiduese të krijuara nga COVID-19. Një rritje e konsiderueshme në vlerat e donacioneve dëshmohej në të gjitha llojet e donatorëve, përveç sektorit të korporatave, i cili mbeti në të njëjtin nivel si një vit më parë. Shumica e mbështetjes filantropike fokusohet në përpjekjet për lehtësimin e varfërisë dhe ndihmës së individëve që përballen me sfida ekonomike. Përhapja e qëndrueshme e kontributeve për lehtësimin e varfërisë nënvizon statusin e saj si kauza e mbështetur më së shpeshti në iniciativat filantropike që janë gjurmuar. Për sa i përket numrit të rasteve të donacioneve, viti 2023 ka shënuar një rënie të lehtë, megjithëse shuma e dhuruar është rritur.

TRENDET E DHURIMIT



KAUZAT


Në vitin 2023, kontributi në lehtësimin e varfërisë u shfaq si kauza më e përhapur në mesin e donatorëve, duke dëshmuar një rritje prej 6.3% krahasuar me vitin e kaluar. Në përputhje me vitin e kaluar, kauza të tjera të rëndësishme morën vëmendje relativisht më të vogël për sa i përket frekuencës së dhurimit. Kjo përfshinte kujdesin shëndetësor (9.5%), mbështetjen për grupet e marginalizuara (7%) dhe arsimin (10.2%). Donacionet drejtuar lehtësimit të varfërisë u përqendruan kryesisht në mbështetjen e njëhershme humanitare, e ilustruar nga iniciativat si shpërndarja e pakove ushqimore dhe ofrimi i zgjidhjeve individuale të strehimit për qytetarët e pafavorizuar në aspektin social.



Duke parë vlerat e regjistruara, 30.9% është regjistruar për lehtësimin e varfërisë dhe 26.5% për mbështetjen e grupeve të marginalizuara. Mbështetja për grupet e marginalizuara iu kushtua kryesisht të moshuarve, gjegjësisht 2 milionë euro të zotuar për ndërtimin e një objekti për kujdesin e të moshuarve në Podujevë.

DONATORËT


Këtë vit organizatat jofitimprurëse u shfaqën si lloji më aktiv i donatorëve, me një përqindje të konsiderueshme prej 41.6% të rasteve të donatorëve, që përfaqëson një rritje prej 27.3% nga viti 2022. Dhurimi masiv-individual (dhurimi nga shumë donatorë të paidentifikuar kolektivisht), kategoria dominuese e vitit 2022, dëshmoi një rënie prej 13%. Individët e njohur mbetën lloji i dytë më i shpeshtë i donatorëve me një përqindje prej 25.3% në rastet e dhurimit.



Sa i përket vlerës së donacioneve, kategoritë e donatorëve më bujarë ishin qytetarët, të cilët kontribuan me 45.8% të pjesës përmes dhurimit masiv individual, si dhe donatorët e përzier, të cilët kontribuan me 27.9% të pjesës së vlerës. Trende të ngjashme ka shënuar edhe diaspora, me pjesëmarrje prej 16.4% në numrin e përgjithshëm të rasteve të donacioneve dhe 14% në vlerën totale.

PRANUESIT


Në vitin 2023, individët dhe familjet ishin kategoria më e madhe e pranuesve që përbënin 52.6% të numrit të përgjithshëm të rasteve të donacioneve, duke zëvendësuar organizatat jofitimprurëse që mbanin pozicionin kryesor në vitin 2022. Kjo shënoi rikthimin e trendit të vërejtur në vitet e mëparshme, kur donacionet ishin të drejtuara kryesisht ndaj individëve dhe familjeve në nevojë. Veçanërisht, donacionet drejtuar shtetit, duke përfshirë institucionet e qeverisjes lokale/kombëtare dhe institucionet publike, pranuan një pjesë relativisht më të vogël në vitin 2023.



Nga ana tjetër, organizatat jofitimprurëse (shoqatat dhe fondacionet private) morën më shumë se gjysmën (59.7%) e vlerës totale.


PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

Në vitin 2023, individët që përballen me sfida ekonomike vazhduan të jenë grupi i përfituesve kryesorë me 62% të të gjitha donacioneve të regjistruara. Kjo shifër mbetet e ngjashme me nivelet e vërejtura në vitin 2022, duke konfirmuar vazhdimin e një trendi të nisur në vitin 2020. Veçanërisht, ky grup i veçantë i përfituesve mori gjithashtu pjesën më të madhe të vlerës totale të regjistruar me mbi 2.7 milionë euro ose 31% të totalit të donacioneve. Ndërkohë që frekuenca e mbështetjes për popullsinë nga komunitetet lokale pësoi një rritje të lehtë në vitin 2023, grupet e tjera të përfituesve ruajtën të njëjtin nivel.



EFEKTET E SYNUARA TË DHURIMIT

Gati 85% e të gjitha rasteve të donacioneve ishin kontribute të njëhershme. Kryesisht, kjo mbështetje i drejtohej ofrimit të banesave individuale dhe furnizimeve thelbësore për individët që përballen me sfida ekonomike. Mbështetja strategjike, e fokusuar në pajisje dhe bursa, përbënte një përqindje më të vogël të frekuencës së donacioneve (përkatesisht 5%). Vlera e regjistruar është përsëritje e modelit të ngjashëm, ku dhurimi afatshkurtër dominonte dhe përbënte një pjesë të konsiderueshme prej 63.9%.



Eksploroni peizazhin e filantropisë në Kosovë për vitin 2023 dhe hulumtoni mënyrat në të cilat qytetarët, organizatat dhe kompanitë kanë kontribuar në mirëqenien sociale [në këtë link](#).

Burimi: kosovadhuron.org



Kjo infografikë është bërë e mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Catalyst Balkans dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.